

V E N D I M
Nr.419, datë 19.6.2003

PËR TRAJTIMIN E JETIMËVE ME SHËRBIM SHËNDETËSOR DHE ME BARNA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9 e 20 të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit” dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Personat që kanë statusin e jetimit me librezë nga drejtuesi i Shërbimit Social Shtetëror, të cilët nuk janë në marrëdhënie pune, kanë të drejtë të përfitojnë shërbim shëndetësor dhe barna falas, sipas përshkrimit të bërë nga mjeku në recetë.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi i miratuar çdo vit për këtë qëllim i Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.

3. Ngarkohen Ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Financave për nxjerrjen e udhëzimit në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano